

Ded Gjo Luli dhe Lufta e Vitit 1911

Zef Marash Doka

Regjistroi Nikoll Dakaj, në vitet 1938-41

Autori i këtij teksti shkruan rreth figurës së Ded Gjo Lulit, Vojvoda i Parë i Hotit, në kontekstin e Luftës së vitit 1911. Ai i qet në pab karakteristikat e Dedës duke tregua reagimet e tij ndaj Turgut Pashës, i cili u përpoq me çarmatosë Lekët, momentin kur Dedës iu vrá i biri në luftë, kur kordonët e Grudës, të cilët i shërbenin Sulltanit, sulmuan traboinasit e Hotit, dhe ofertat tjera që otomanët i banë Dedës me kusht që ai të mos luftonte kundër tyre. Mâ tej, autori tregon për gjendjen ekonomike të Dedës, dhe si Deda trajtonte vegjlinë, gratë, dhe fëmijet.

Përshkrimi i Ded Gjo Lulit

Ded Gjo Luli â njezh mâ i miri burrë në Hot e në Malsí, e e kanë dashtë e hatruo Shkodra e Malet, e i kite shkua zani në derë të Stambollës e ndër krala. Â kenë Vojvoda i parë i Traboinit e i ká prî të tanë Hotit mâ shum se Flamurtari. Ká lé, siç e báj llogarí û, mbas vjetve qi ka pasë, rreth 1840-tës në Bardhaj të Traboinit, krejt njëty ku i thonë vendit “Kûji i Gozdjenit”, se i Gozdjen â kë Deda:

Me shtat â kenë burrë i zakonshëm, mâ fort i shkurtë se i g’jatë. E s’ka pasë aq pashí, por ite ftyr-ambël e goj-mjaltë e i pastër e i veshun, me ta lypë syni m’e pá e me ta hjekë zemra me ndêjë me tâ. Zanin e ká pasë të trashë, ka folë kadal-kadalë e fjalë në tokë s’i ka rá. Â kenë pak i remtë ftyret, me sý zjarm e të dashtun, e vetulla të trasha, e mustakët e mbajtun i nepshn hijen e burrit zotní. I ká pasë hije

vesha: në daç tirqit e bardhë e kraholi i arit, në daç kapica devjet e shalli i larmë në krye. E mâ bukur se gjithçka i kanë ndêjë armët e brezit qi s’ka shkua kurr pá to. Mendja i ka pré hollë e s’ka ndigjuo me shkelë kan me kambë as m’e folë i fjalë për i tjetër kurr. I thjeshtë, i matun e pa aspak mende të madhe. I idhtë tuj mësy anmikun e i tërbuom me i pa folë kush gjâ kundra Shqipnisë e lirisë. Siç ja ka hjekë dera e siç ja kanë lanë në ledh të parët, trim i çartun e besnik, fisnik e i pritun në shpí e në shoqni. Shkurt bjeseda, me pa kqyrë me ja gjetë ‘i gand në shpirtin e në të prûmit e tí, je munduo kot.

E me të tana këto të mira, â kenë edhe i vogël me të vojlit. Edhe me gruo e me fëmí ka denjua me u ndalë e me folë. Kurr s’e harroj, isha fëmí një katër a pesëmbëdhjetë vjeç e



dola në lagje të t'ij në Bardhaj me marrë i mështierë qi i kija blé Lek Keqit. Mështieria ite e egër e me vështirë e tërhiqshem për lakut. Kur po del prej shpiet Ded Gjo Luli i veshun e i mbathun me rá në Tuz. E kur më pa në atë vështirë me atë të granë drej mështieret, erth me më ndihuo e m'i ka grahë deri te shpia, tuj kuvendë me muo si t'ija i burrë shoqi i tí.

Por me të mdhej e zyrtarë ite i fortë e s'ja hate qeni shkopin. Kallzojshin, se kur e zgoth populli në Xhibal e shkoí në të s'parit, i ka thanë pasha:

- Fol, Hot!

-Po flas, pashë, - ia kthey Deda - por kur të flas û, njashtu duo m'e lanë.

E pasha, atë ditë e mbrapa si ka pleqnuo Deda, ashtu e ka lanë.

Me Shqipni s'ka vû asgjá e shpesh thote, kur mundohej pasha i Shkodrës o Kral Nikolla m'e blé me flori:

- Shqipninë s'e shes as s'e fali. Nuk jam mish me u shitë në krrabë.

Më ka kallzuo i herë Patër Bonë Nika, i frat i hollë e i g'jatë prej Shkrelit, se e paska thirrë valia i Shkodrës Dedën e i paska thanë: "Ded Gjoni, falmeshëndet ke prej Mbretit të Stambollës, e t'i ka çuo njëkto 400 lira, e mos me dalë koçak edhe në daltë Hoti."

- Falmeshëndet thuoji mbretit - i tha Deda - në dalët Hoti koçak, edhe û i Hot jam e s'kam si dahem vllaznish.

E krejt njatë natë ka ardhë e më ka lypë në kuvend të fretënve - më tha prap Patër Bona - një mexhitë të bardhë deri shtegut tjetër qi të bite n'Skodër, se s'kite me çka blente as bukë e kos për darkë. E ja dhashë e shtegut tjetër m'i pruni.

Edhe një famullit të vet qi i çou natën një fishek me lira prej Kral Nikollës, Deda i Tha, "Thuoji atij qi t'i ka dhanë, t'i thotë Kral Nikollës se û jam Ded Gjo Luli i Hotit e as ti as kurr i kral s'ka pare me më blé."

Ite në Podgoricë Deda, kur i mbet i biri, Gjergji, në Qye [maje] të Dolecit, e Hotnit qi shkuon me i kallzuo i thanë: "Na mbetën shum djelm Hotit e Grudet, Dedë."

- E po dazëm pa mish s'ka - u tha Deda. Burri në luftë me dekë shkon.

- Po na ka mbetë Dedë, edhe yt bir, Gjergji.

Aty Dedës iu skjaruo ftyra e tha: "Me thanë të drejtën, po kam mirë, burra, se u kanë mbetë djelt të tanë Hotit e Grudës e û me i pasë të dy shëndosh, nuk më duket bukur."

Ded Gjo Luli ite i parë në luftë, i njoftun prej Hotit e Malesh po s'e ka ndie kush kurr tuo shtý kan përdhunë me i dalë në ballë anmikut. Në fjalimet e shkurta qi mbante ai thote shpeshherë:

Shqipëria dubet me u bâ, burra. E pa gjak s'i shtibet temeli. Dubet burra me fituo o me dekë. Û jeshtu kam qiej. Û e kam dá mos me i dorzuo armët për të gjallë. Shpinë e tesbat i kam në kalë. Ju burra bani si të doni, po Û kujtoj se ndera jonë ásht me bâ luftë e me dekë për lirim të trollit tanë.

Njeksi burrit â kenë Ded Gjo Luli. E kush e ka njohtë vetë e ja ka pá punët, nuk mundet me folë ndryshe për tâ.

Ikja në Mal të Zí e Fillimi i Luftës

Kur erth në Shkodër Dërgut Pasha e qiti fjalën me shtruo e me i marrë armët edhe Malsís e Dukagjinit, si në Kosovë e në të gjithë Shqipëri, Hoti, e sidomos Traboini, ishin gati me i dalë përpara me pushkë si gjothmonë. Por Ded Gjo Luli s'ja pa g'jasën aq shpejt. E u çuo i natë natën e bashkë me 11 shpi tiera duol në Triesh, në Mal të Zí.

Shpiat që ikën në Mal të Zí janë: *Ded Gjo Luli, Gjek Marash Gjeloshi, Nik Gjelos Luli, Marash Lan Ula, Kol Marash Vata, Nik Gjelosh Leka, Gjo Vat Pali, Luc Muç Elezi, Gjo Nik Pllúci, Prël Prék Zeka, e Cubà Dëli.*

Këta, prej Trieshit shkuon në Podgoricë e aty ja nisën punës me u gatuo për luftëm sa mâ parë qi me mujtë.

Përmas tyne ikën atje edhe 10 shpi Grudë e Mehmet Sphendi me 10 shpí Shalë.

Dërgut Pasha atherë duol në Tuz e hini në Traboin. Mbloth armët e dogj shpiat e atyne qi kishin ikë. Shpinë e Nik Gjelos Lekës e të Prël Kerit i shembi me top, e të tjerave u vuni zjarrë. Në Mal të Zí, Ded Gjo Luli u prit mirë prej Malazezve, se kanë pas edhe ata burrni mjaft. Krajl Nikolla edhe i dote, por edhe s'la gúr pa luojt me i bê për veti, qi, kur të hiqej Turku, ata të lypshin flamurin e tyne e jo të Shqipnisë. Por Deda, Dedë se Dedë, s'u shtruo, por u bâ gati me gjith shokë e më 24 Mars 1911 u kthye në Hot, ku i rá Turkut e zaptou dý postat ushtarake në Grykë te Leqes e Rranxë Raset pa asnji dam. E fjala muor dhén. N'e nesret, Kelmendasit muorën postën kufitare të Vermoshit e Grudët trí postat e veta.

Kardunët e Grudës kundër Lekëve të Trabonit

Njâra postë e Grudës ite në shpí të Ujk Gjiekut. Ky kur ndieu se u muorën dý postat në Hot, jau mbushi menden kordunave m'e lëshuo atë postë e i përcollí me armë për Tuz. Rrugës ndeshën Tahir Mujin, postkomandantin e Tuzit, shqiptar prej Dinoshet e në shërbim të Turkut.

- Po ku ini nisë, u tha - he, u kjoftë haram buka e Mbretit! Po a s'mujtit me dekë në kaushë, tuo pasë pushkë e fishekë boll?

- Po ti në daç me dekë - ja ktheu bujrizani e në t'â mërzi të jeta, njaty tek â Traboini, por njâ, druo s'pshtojmë as sa për kumt.

Aty u nisën për Traboin me pushkë gati, një mbas njëi me Tahir Mujin në báll.

Beteja në Ciepur

Ite dita e lajmit të Zojës (25 Mars), e kisha e Traboinit ite mbushë plot edhe për festë, por edhe për me u pá me ata trima që i banë shtëpijat hî për nderë të Shqipnís e të Hotit, kur patën lshuo plang e shpí e ikë në Mal të Zí. Mendja jonë po kena festë e gëzim si askurr; se Ded Gjo Luli kite ardhë me flamur në dorë e mos me njoftë Turk mâ në këtë vend. Por, tuo dalë prej kishet, u muor vesh se Tahir Muji ka msy Traboinin me korduna të Grudës. A aty të tanë mashkullia tuba-tuba, me çka na kite qilluo në dorë, u nisme me i dalë përpara.

Kur mbërime në Ciepur, që ite i bokrrinë në tokë të Prël Kerit, na, që ishin tuba e parë, u dame dýsh: do po ecim kodraçes sipër, e Kol Marash Vata, Zef Lan Ula, e do tjerë po ecin përfund nesh, rrugës që n'atë vend ngushtohet fort e â tan rrasa e me kthesë të keqe. Na ecshim tuj kuvendë të madhe si me kenë tuo shkua n'dazëm, e ata, besa, na duolën përpara pa bâ zâ aspak e na filluon pushkën aty në mâ të keqin vend. Pushka e parë varrou Zef Ujk Smajlin tanë e atherë Tahir Muji u ndesh trup me trup me Kol Marash Vatën e i nguli bajonetën, e i shprazi pushkën në parzën; e Tahirit, ja pret pushkë në shtek të Ballit Zef Peri, e rrëzohen të dy dekun një mbë një. E prapë një më një, Hotën e korduna, bien Zef Lan Ula, Ujk Gjesh Leka, Fran Zek Pllumi, Gjon Lulash Zeka e Zef Lulash Zeka (vllazënit e nipat e Franit), Pjetër Uc Martini, Nikoll Mirash Gjiekë, e Zef Gjoka prej hotësh, e 13 korduna. Një kordon tjetër iku, e dy tjerë na ranë në dorë; njëri Mark Gjietos e tjetri Prêç Dedës. U varruon edhe Mark Gjesh Luka, Gjo Nik Marku, e Lan Zefi.

Disa po kqyrshin të mbetunit, do u bishin mbrapa të varruomvet, do bájshin poterë pse me i falë ata të dy kordunat, kur u derth gjith ai gjak trimit, e do tierë afroheshin prapë tuba-tuba. Atherë po ja mbërrinë dikur edhe Lulash Zeka tuo u dridhë, që ishte i vllau i Fran Zek Pllumit edhe i atë i Gjonit e i Zefit që kishin mbetë, e tha, "S'po më dhimben, burra, dy djelt, por po kam keq se më paska mbetë Frani".

Sulmi i parë prej Tuzit

Pa vonuo shumë, atë ditë fill, kajmekami i tuzit nisi për Traboin një forcë të madhe që duol te kisha. Na erth lajmi, e u lëshuome i math e i vogël me i dalë përpara. Kurrkush s'drote me dekë, kaq fort ishim fry në ta. E i pari mbërrini Gjok Ded Luli, që i kecu psirmit ushtarit me pushkë ngrehun e ja muor për gryket. Iu varruo dora, por Turqve u hini tmerri e u vunë me ikë kah kroni i Radeqit për Skorraq. Kishte nisë me kapë mugu e bite i logrinë shí e ata ik prej tramet. E tuo ikë për Skorraq duol në shkallë Prêç Prëla e

vrau i ushtar turkut e i briti njëj t'Hotit, kam harruo tash se kuj, "A, merrja pushkën, he burrë, se û e kam!"

Këtu mbetën dekun tre vetë prej Turkut e u varruon 30 a 40 sish, ndërsa prej nesh ishte varruo edhe Zef Vuksani atje në Radeq.

Sa u err mirë, ushtria e Turkut me zi ç'priti me u dredhë e me ikë e druo s'jan ndalë kund pa hî në Tuz. Por edhe të plaguomt i tërhoqën me veti, e i herë për i herë lufta pushoi. Mbasi u caktuon rojet, u nisa në shpí teme bashkë me Gjek Marash Gjeloshin e Nik Gjelosh Lulin qi fjetën te un atë natë.

N'e nesre u mbloth të tan Hoti në Ciepur te Kol Marash Vata me shokë, qi e lau me gjak i pari tokën e Traboinit në këtë mâ të madhen luftë. E Nik Gjelosh Luli mbajti një fjalim të bukur qi u mahnitën të tanë. Foli me u vllaznuo kundra Turkut e mos me u vrá mâ me Shqiptarë ndër veti (Kordunat e Tahir Mujit ishin Shqiptarë). E i kemë çuo atherë e shtû në dhé në Kodër të Kishës (Vorret e Traboinit).

Sulmi i parë kundra Tuzit

Qysh tash u caktuo paria e luftës, qi kryesonte të tana punët: sulmin, mprojtjen, tërhiqjen edhe ndamjen e rojeve. Këta ishin: Gjek Marash Gjeloshi, Gjon Ujk Miculi, Gjo Nik Pllûci, Nik Gjelosh Luli, e Kol Doda; dhe në krye të të tanëve ishte Ded Gjo Luli.

Ushtria ite e bame prej Hotësh, Grudësh, Trieshjanësh, Koqasish (Kuçash) e rrall ndonjë prej malesh tiera qi i kite zanë puna në Hot.

Nuk ka pasë asnj Traboinas të rritun që të mos ketë marrë pjesë në luftë. Në katund a mbas krahësh kanë marrë pjesë edhe gratë qi ofrojshn ushqimet e i vishin rresht burrnimit në báll të luftës me çka mûjshin. E në këto, janë dá me gisht Tring Smajlja, e bija e Flamurtarit të Grudës, e Nore Kolja, e reja e Ded Gjo Lulit. Këto bajshin livore e Tringa ka i herë ka përdorë edhe armë të g'jata.

Armët shkuome e i muorme në Vrella, pak këndeje Podgoricet. Muorme të gjithë 'novica' me fishekë a s'mbet kush mâ i paarmë.

Kur u paisme mirë me armë e u bame krejt si ushtrí e rregullt, bashkë me Grudën mësyme Tuzin. Na duolën përpara ushtarë turq po forcën tonë s'e pritte gjá. T'i rame Tuzit o djalë, e e buome me ikë e me u ndry në kështjellë, qi ásht në krye të qytetit e i thonë prej popullit Shipshanik ose kështjella e Tuzit.

Kur hime në Tuz, e pame se kështjella ite e fortë për mjetet e armët tone, dogjëm dy kishllahet (kazemat) e ushtrisë qi ishin ka 50m të g'jata, sarajin e kajmekamit, furrën e bejlikut, e magazinën e krypës.

Kështu tash Ded Gjo Luli kite Shqipni të liruome Kelmendin, Hotin, e Grudën. E gëzimi i popullit e uzdaja e tina s'kishin mbarim. E nisën me dalë kangët aty për aty për secillën trimni qi bâhej.

Flamujt

Qyshë kur ite Ded Gjo Luli i ikun në Mal të Zi e mâ vonë edhe në Hot e në Grudë, kanë ardhë gjind e zotni prej gjithkahit me u përpykë me tâ e me pá edhe punën tanë. Û nuk i kam njohtë se Û kam kenë i rí atherë, por atje jau kam zanë emënin disave si Luigj Gurakuqit e Hil Mosit e do shkodranëve tjerë. Kite edhe të huoj. Si tash më duket se e shoh përpara i Ustriak qi i thojshin për emën Baron. Rrite mâ fort me Dedën, por bërzihet edhe me ne, edhe në valë të pushkës. Ite një 40 vjeç e njashtu si Deda me shtat. Këtâ e mbaj mend se kite i mazere me turbi psirmit e ja kisha lakmi mjaft. Kite edhe aparat e merrte piture shpesh. Kite edhe i parë çizme me gomë të kuqe përfundi, qi kërсите tuo ecë.

Prej kësi gjindësh na kishin ardhë edhe flamujt e Shqipnisë, prej Shkodret e prej Cetinet, prej Dallmaciet, e thojshin edhe prej Ameriket. Këta i mbajshin në Skorraq në shpí të Prêç Prêlës, qi s'kite kan por i gruo, e ja kite lanë për magaze Hotit. Aty daheshin pushkë e fishekë e bukë e çka na duhej. Aty ja dha Ded Gjo Luli flamurin Nik Gjëlosh Lulit e ai u nis vet i treti e e nguli në një grmbull gurësh në maje të Bratilës, qi vjen pak mâ ketej Deçiqit. U pre mish e prune gjindja raki e venë prej shpiash për m'e lutë si festë. E ka ndejë mjaft kohe ngrehun e e ruojshin rojet tona gjithmonë. Ky flamur â i pari qi â vû në Hot. Âsht fjala se flamuri â vû s'parit në Deçiq, mal krejt pi Tuz e në tokë të Grudës. A vû për i mend, por Û s'di kah jam kenë e me sy s'a kam pa, si ite atherë.

(?Dërgut Pasha prej Hanit t'Hotit e deri në Tuz e edhe na ishin hapë maje në maje). Atâ jau ka dhanë Deda Pjetër Zef Smajlit të Hotit (i Gojçë) e Ded Luc Hasit, Triezhan, qi e vunë bashkë në Deçiq. E s'ka ndejë i ngreun shum, se do ta kija pá. Flamuri në Bratilë i bjen me kenë vû me 1 Maj 1911, pse Nik Gjëlosh Luli u vra prej gjyles së topit të tretën ditë qi pat ngulë flamuri. E për tâ e dimë të tanë se â vrá ditën e Shna Kryqit, qi i bjen gjithmonë më 3 Maj.

Ite ai flamur sa i çarçaf i vogël me thekë e tufa arit. Në mjedis kite shqipen me dy krenë. Shtëja (shtëza) ite e lyeme një ngjyret e me zogj arit me krahë në maje; arit i thoshin na, pse ishin në ngjyrë të verdhë për bukurí. Ka pasë edhe rrypin me e bajtë krah e qafë e në fund të rrypit kite një si gotë, me shtë në tâ fundin e shtës. Një ditë â kenë për ne bash dita e Shqipnis, tuo qitë pushkë e tuo pí e tuo kënduo në kupë të kresë. Edhe tash po më duket se po i ndiej tuo kënduo maje krahit Gjok Lulin me Ujk Lucën e në krah tjetër Gjok Metin me të vllanë.

Lufta e Dytë

Shkodra mejherë ja çou ndihmën Kajmekamit që kite mbetë i rrethuar në kështjellë. Duol tellalli në Shkodër, si na thojshin, e rrëzoi njerëzit se â Dini në rrezik e se kryengritësit janë bân me Mal të Zî e don me na pushtua “atdheun”. E u banë gati i mí vetë e për Liqë duolën në Hot e krisi pusha në Samoborr. Na kjeme terbuo në ta, se u tokote ma na ndihmuo e jo me na trathtuo. E i kemë buo nëpër Vuksalekaj, e deri në Tuz. Atje s’i lame të qetë prapë e i thyme keq, e me pështuo, kjenë ndrý nëpër shtëpia të Dinoshës. E kur u panë se po mbesin të tanë, na u dorzuon. E u kemë bân çka s’ban kush në kan; çveshë teshat e nisë me lundër, në këmishë e në klina pë Shkodër.

Sulmi i Dërgut Pashës

Dërgut Pasha u bân me dalë mëç kur pá ç’po bâhet në Hot e në Grudë e në të tana malet e çou në kambë të tanë ushtrinë e vet e duol e ngrehi çadrat në Koplík e topat në Bajzë të Kastratit e rrahte me ta Veleçikun se atje ite grumbulluo Kastrati me i ikë rrezikut të parë. Por disa tjerë të Kastrat, ata mâ trimat, duolën në Hot, ku e dishin se e ka synin Dërguti.

Ushtria e Dërgut Pashës del në Han te Hotit e ndeshet aty në Malsí, që ite shtrënguo mâ fort se as i herë me pritë 100 taborret e tina. Vetë Ded Gjo Luli i kite dalë përpara në maje të Dushkut të Dakut, e përkundruoll Hanit të Hotit. Ishin n’â (?) një 70 a 80 vetë, e Dedën e kam pasë shqim afër e qitte pa pushuo në Turk me i novicë të shkurtë, si me kenë 20 vjeç djalë e jo mocë me tem atë, që kite hî në dhé 10 vjet mâ parë.

Me fuqí mësyte ushtria, por mâ me fuqí na, që kishin zanë të tana majet, prej Sukës së Zezë, kudruoll Hanit të Hotit e deri në maje të Deçiqit. Turku shkojte tuo mbetë, këtu një e aty tre - katër, po te na s’munt t’kapej. Atherë mësyni prej Tuzit me marrë Bratilën e Gjelevikun, këndeç Deçiqit, por they kryet kot. E u hap prapë prej Hanit t’ Hotit e deri në Deçiq e nisi me fuqí me i marrë ato maje mbi Tuz o me dekë.

E u ndez aty luftë e fortë; e sulmon turku prej Tuzit me kapë majet. Kërlogshi, Bratila, e Deçiqi mbushen plot me malsorë e në krah të Drumës së borës mbesin (?) do (?). E djelt e rí ulen prej majesh në bria poshte për me i hî mbrendë anmikut. Afrohen ushtarë te na deri sa me i gjuo prej afër, po ata luftojnë si me zor, e sa na i shohin sytë çojnë e na i hjedhin pushkët me na u dorzuo. Na merrshim pushkët e i lejshim me shkuo prap në Tuz. Kur pame se ishin të ligsh-tuom, mësyte me hî në Tuz e u bân gjak i math në të dý parët. Turq jithshin sa uji e prej nesh mbetën asajt: Lek Marash Peci, Tom Lek Ula, Gjok Kol Preli, Nikash Zef Peri, Fran Gjeto Deda, Kol Dok Prêtashi, Zef Vuj Ula, Gjo Marash Loshi, Prék Zekë Makaj, Ded Gjon Ujka, Nik Ujk Haxhija, Nikoll Mirash Prêli e tuo hî mbrendë në Tuz: Gjon Ujk Çeku, Gjo Pllum Maçi, Prêloc Mark Gjeka, Prék Gjok Prêli, Ded Marash Gjeli, a në qafë t’Ugëls, Prêlot Gjeloshi e Luc Ujk Gila. Gati kaq kjenë edhe të varruoit në Bria të Tuzit.

Për mâ se i muoj taborret e Dërgut pashës shkuon tuo shetitë prej Hanit t’ Hotit deri në Tuz, pa mujtë me hipë kund majesh. Por dikur ajo ushtri e me gjith ato mjete mësyni me hî në Traboin

kah Porgjeli e kahë Kodra e Keqe. Û e Prêk Mirash Curi, mocatarë me mua, ishim në Progjel krejt në báll t'ushtrís bashkë me Marti Lek Dedën, Dedvukajsh, trim i tërbuom. Shokët tanë, e tanë Hoti e Malet, ishin zmbrapë në Brimollë e na s'kishin pasë fjalë apo s'kishim ndie, a s'e di, por luftojshim tre vetë me i ushtrí, pa dijtë gjâ as na, as ushtria.

Vite breshni i plumbave përpara e kryq e kryq, e keputte rremat e frashnit e na bijshin shpinës. Fishkullima e plumbave shtohej e afrohej, po Martini mbush e qit e me sy kokërr si me kenë në log të kishës tuo gjuo shêjin.

Dikur, -Martin, i thashë, po ti a po i sheh plumbat kryq e kryq? Na kanë shtú në lak.

-Uuhl, gjimon në zâ - përpjetë mbas mejet briaza!

Nuk i patme bâ as 10 hapa kur, pa bâ zâ, na kapi për manget e na qiti mbi veti a na tha: - Më prîni tash ju muo, se ini djel të rí.

Kur duolme nën Jagodë, pame astjerin nëpër Spî e deri në Skorraq, e kur u ndeshme me shokë kaluome me ta andej Cemit, e n'e Malit të Zí, me armë në dorë e tuo pritë ditën me i rá prapë turkut për mâ të mbramen here.

Meditimi Përfundimtar i Autorit

Kur duolme të tanë si ishin në Mal të Zí, u bâ i bliedhe në Greçë (në kufi të Triepshit). Aty ishin Smajl Qemali e Luigj Gurakuqi e dhanë e muorën sa mujtën me na mbushë menden me i kërkua mbretit ato pikat e librit te kuq. Na imë të vojl me folë në mbliedhe, por na vite çudë si *“këta dy gjind shkollarë edbë e kanë menden te Turku. Po na këto dubej me i fituo vetë, e jo me ja hypë atij, qi s'mundej as s'kite as me na i dhanë as me na i hiekë.”*

Zef Marash Doka (Dakaj)

Zef Marash Doka ishte i jati i autorit e përkthyesit Nikoll Dakaj. Sipas të nipit të Zefit, Antonit, Z. Doka e dinte Epikën e Trimave për mendësh dhe nuk shkonte me fjetë pá këndua njënen prej këtyne kangëve (KGj, 158, 162-72)